



Klasat e rakordimit

Informacione për prindërit

**Shkalla e dytë
(arsimi i mesëm i ulët)**

Rac1 dhe Rac2

Në plotësim të fletëpalosjeve që paraqesin klasën e 9-të, të 10-të dhe të 11-të^e të shkallës së dytë I (cikli 3), ky dokument përshkruan klasat e rakordimit 1 dhe 2. Ai paraqet karakteristikat dhe veçantitë e këtyre klasave: kushtet e hyrjes në to, organizimin e tyre, lëndët e ndryshme dhe tabelën e orarit, mënyrat e vlerësimit dhe kushtet e certifikimit të nxënësve..

Klasat e rakordimit 1 i mundësojnë nxënësit që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm, nëse rezultatet e tij plotësojnë kërkesat, hyrjen në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose të maturës profesionale.

Klasat e rakordimit 2 i mundësojnë nxënësit që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm marrjen e certifikatës të drejtimit paragjmnazial.

www.vd.ch/scolarite

Burimet : Loi sur l'enseignement obligatoire (LEO)
Règlement d'application de la LEO (RLEO)
Cadre général de l'évaluation (CGE)

Bazë janë kuadri ligjor e rregullator dhe Kuadri i përgjithshëm i vlerësimit (CGE), i cili trajton në mënyrë shterruese rastet e ndryshme.

Të përgjithshme

Klasat e rakordimit kanë për qëllim t'i mundësojnë nxënësit, në përfundim të një viti mësimor shtesë dhe me disa kushte, hyrjen në degë të ndryshme të formimit pas shkollimit të detyrueshëm.

Vendet e mësimdhënies

Në shumë institucione të shkollimit të detyrueshëm të shpërndara në territorin e kantonit të Vaudit, ka klasa të rakordimit. Në parim, fëmija shkollohet në institucionin shkollor më të afërt me vendin e banimit. Sidoqoftë, zhvendosjet jashtë zonës së regjistrimit mund të jenë të nevojshme për të baraspeshuar numrin e nxënësve në klasa.

Të drejtat dhe detyrimet

Klasat e rakordimit vihen në varësi të drejtorisë së institucionit të shkollimit të detyrueshëm. Nxënësit që ndjekin këto klasa kanë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat detyrime si edhe nxënësit e tjerë të shkollimit të detyrueshëm.

Falas

Ndjekja e klasave të rakordimit është falas. Zhdëmtime për transportin u jepen nxënësve që banojnë mbi 2,5 km larg vendit të mësimdhënies.

Mosha më e lartë

Nxënësi mund të jetë e shumta 17 vjeç në 31 korrik të vitit të regjistrimit.

Regjistrimi

Kërkesa e regjistrimit për të ndjekur një klasë të rakordimit duhet t'i drejtohet prej prindërve, në fund të muajit janar, institucionit shkollor të ndjekur prej fëmijës së tyre në vitin e 11-të. Formularët e regjistrimit gjenden pranë mësuesit/es kujdestar/e të klasës ose sekretarisë së institucionit shkollor, si dhe në sitin e Internetit www.vd.ch/scolarite¹.

¹ Rubrika Déroulement de l'école obligatoire dans le canton de Vaud.

		Rac1 et Rac2 viti i 12-të certifikues		shkalla e dytë I (arsimi i mesëm i ulët)
14 - 15 vjeç	11S	cikli i tretë drejtimi i përgjithshëm	cikli i tretë drejtimi paragjimnazial	
13 - 14 vjeç	10S			
12 - 13 vjeç	9S			
11 - 12 vjeç	8P	cikli i dytë fillor		
10 - 11 vjeç	7P			
9 - 10 vjeç	6P			
8 - 9 vjeç	5P			
7 - 8 vjeç	4P	cikli i parë fillor		
6 - 7 vjeç	3P			
5 - 6 vjeç	2P			
4 - 5 vjeç	1P			

Struktura e shkollës së detyrueshme vaudeze

Në mënyrë të përgjithshme, **rastet e veçanta** kanë të bëjnë me rrethanat në të cilat rezultatet e nxënësit janë shumë pak poshtë atyre të kërkuara për plotësimin e kushteve të certifikimit ose të hyrjes në klasat e rakordimit, si dhe të pranimit në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve. Këshilli drejtues vendos kryesisht për rastet e veçanta.

Këshilli drejtues çmon, me kërkesën e prindërve, **rrethanat e veçanta** të gjasshme (për shembull një shkollim i trazuar rëndë e për një kohë të gjatë nga një sëmundje e zgjatur, nga mbërritja rishtazi nga një kanton tjetër apo nga jashtë vendit). Që një rrethanë e veçantë të merret parasysht, duhet që një sukses i mëpashtëm të gjykohet i mundshëm.

Vendimet lidhur me certifikimin, hyrjen në klasat e rakordimit apo të mësimin plotësues, si dhe pranimin në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve mund të bëhen objekt i një ankimi pranë Departamentit : *Instruction des Recours, Département de l'enseignement et de la formation professionnelle, rue de la Barre 8, 1014 Lausanne*. Ankimi i motivuar bëhet me shkrim brenda një afati 10-ditor nga njoftimi i tij dhe shoqërohet me një kopje të vendimit të kundërshtuar.

Vlerësimi

Në vazhdimësi të mënyrave të vlerësimit në fuqi nga klasa e 5-të në të 11-tën, vlerësimi i punës së nxënësit njoftohet me anën e agjendës, në formën e notave që shkojnë nga 1 deri në 6, me gjysmë-pikë (TS dhe TA). Nota 4 përkon me pragun e mjaftueshmërisë. Nota më e lartë është 6-ta, nota më e ulët 1-shi.

Mesataret e mara prej nxënësit mbahen parasysht sipas një sistemi me kusht të dyfishtë: vendimet lidhur me rrugëtimin e nxënësit bazohen në shumën e pikëve të mara në grupin kryesor të përbërë nga të gjitha lëndët nga një anë dhe në një grup të kufizuar lëndësh nga ana tjetër.

Në mbarim të semestrit dhe të vitit shkollor, jepet një vlerësim i gjendjes. Ai përmban një listë të notave dhe të mungesave, si dhe mesataret e lëndëve të llogaritura me gjysmë-pikë më të afërt. Në fund të vitit shkollor, një dëftesë përmbledh mesataret dhe tregon vendimin lidhur me certifikimin e nxënësit. Kjo dëftesë i bashkëngjitet librezës shkollore.

Certifikata e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë

Në fund të vitit shkollor, organizohet një provim për certifikatën në institucionin shkollor. Mënyrat e zhvillimit të provimit janë të njëjta me ato të fundit të vitit të 11-të.

Për të marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë, nxënësi duhet të ketë ndjekur mësimet në klasën e rakordimit dhe të jetë paraqitur në të gjitha provimet.

Certifikata e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë jepet në bazë të mesatareve të mara në fund të vitit të rakordimit. Mesataret e fundit të vitit përcaktohen sipas mënyrave që vijojnë:

- Për lëndët që nuk janë objekt provimi, mesatarja vjetore përfundimtare përkon me mesataren vjetore, të rrumbullakosur me gjysmë-pikë;
- Për lëndët që janë objekt provimi, mesatarja vjetore përfundimtare mban parasysht mesataren vjetore në masën 80% dhe notën e marë në provim në masën 20%.

Nxënësit dhe prindërit e tyre kanë mundësinë të shikojnë fletët e provimit pasi ato të jenë korrigjuar.

Punët domethënëse (travaux significatifs, TS) (përdorimi i njohurive): në mënyrë të rregullt e gjatë tërë vitit, vlerësimi i punës shkollore të nxënësit bëhet me ndihmën e punëve domethënëse. Ato përbëjnë elementet thelbësore të vlerësimit. Çdo punë domethënëse synon të paktën një objektiv mësimor të përcaktuar nga Planioromand i studimeve (PER) me një apo disa prej përbërësve të tij që kanë qenë objekt i një mësimdhënieje.

Punët e përvetësuara (travaux assimilés, TA) (përvetësimi i njohurive): Një sërë punësh që verifikojnë vetëm përvetësimin e njohurive apo të teknikave të veçanta. Ky grup punësh janë objekt i një note për lëndë. Për secilën prej lëndëve, numri i punëve të përvetësuara nuk mund të kalojë një të katërtën e tërësisë së punëve të përcaktuara.

Mesatarja vjetore, shembull llogaritjeje	Mesatarja e notave të mara në klasë	4.2
	Nota e marë në provimin e certifikatës	4.5
	Llogaritja: $(4.2 \times 0.8) + (4.5 \times 0.2) =$	4.3
	Mesatarja vjetore përfundimtare (e rrumbullakosur me gjysmë-pikë)	4.5

Certifikimi në fund të vitit të 11-të

Një fletëpalosje shpjeguese që paraqet kushtet e certifikimit të nxënësve të vitit të 11-të dhe kushtet e hyrjes në formimet pas arsimit të detyrueshëm gjendet në sitin e Internetit:

www.vd.ch/scolarite > Déroulement de l'école obligatoire dans le canton de Vaud.

Klasat e rakordimit 1

Paraqitje

Pas një viti shtesë në shkollimin e detyrueshëm, klasat e rakordimit 1 i mundësojnë nxënësit që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm të arrijë rezultatet që lejojnë hyrjen në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose maturës profesionale.

Kushtet e hyrjes në klasat e rakordimit 1

Nxënësi/ja i/e certifikuar në drejtimin e përgjithshëm mund të hyjë në klasën e rakordimit 1 me kushtet vijuese:

Tri lëndët e ndjekura në nivelin 2: frëngjisht + matematikë + gjermanisht	12 pikë e sipër
ose	
Dy lëndë të ndjekura në nivelin 2 dhe një lëndë e ndjekur në nivelin 1: frëngjisht + matematikë + gjermanisht	13 pikë e sipër
ose	
Një lëndë e ndjekur në nivelin 2 dhe dy lëndë të ndjekura në nivelin 1: frëngjisht + matematikë + gjermanisht	14 pikë e sipër
ose	
Të tria lëndët të ndjekura në nivelin 1: frëngjisht + matematikë + gjermanisht	15 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta</i>	<i>e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në shumën e të gjitha pikëve.</i>

Në raste të jashtëzakonshme dhe në bazë dosjeje, departamenti mund të bëjë përjashtime nga rregulli për kandidatët/et që nuk plotësojnë kushtet e hyrjes në klasën e rakordimit 1.

Kërkesat

Në fund të vitit të kryer në klasën e rakordimit 1, nxënësit duhet të kenë marrë të njëjtat njohuri dhe të njëjtat aftësi si nxënësit e vitit të 11-të të drejtimit të përgjithshëm që kanë ndjekur tri lëndë me nivel (frëngjisht, matematikë dhe gjermanisht) në nivelin 2. Kjo kërkon një qasje të thelluar të lëndëve tashmë të studiuar, në përputhje me objektivat e përcaktuara nga Plani romand i studimeve (PER) për ciklin 3. Nxënësit duhet të jetë i motivuar dhe i gatshëm të bëjë një punë të rëndësishme dhe kërkuese, edhe jashtë kohës shkollore.

Plani romand i studimeve (PER)

www.plandetudes.ch

PER-ja përcakton përmbajtjen e të nxënësve të shkollimit të detyrueshëm për Zvicrën romande. Ai përshkruan atë që nxënësit duhet të mësojnë gjatë njëmbëdhjetë viteve të shkollimit.

Kërkesat për përjashtim nga rregulli lidhur me pranimin në klasën e rakordimit 1 duhet t'i drejtohen dekanes kantonale të këtyre klasave (shih të dhënat përballë). Ato duhet të përmbajnë një letër nga prindërit ku të përshkruhet konteksti i kërkesës, të shoqëruar me formularin e regjistrimit, si dhe me një dosje të plotë. Për këtë qëllim, prindërit dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për të kuptuar rrugëtimin shkollor të nxënësit dhe nivelin e zotërimit të objektivave të planit të studimeve, në veçanti dokumentet zyrtare (dëftesat e fundit shkollore, certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë) të lëshuara nga institucioni në të cilin nxënësi/ja është shkolluar, si dhe çdo dokument tjetër i duhur.

Tabela e orarit

Klasat organizohen sipas modelit të drejtimit të përgjithshëm. Tabela e orarit përmban nga 32 deri në 34 periudha në javë sipas ndarjes përballë.

Përforcimi i nivelit 2 përbëhet nga tri deri në pesë periudha në tabelën e orarit sipas profilit të nxënësit:

- Tri periudha përforcimi të nivelit 2 ndiqen nga të gjithë nxënësit me qëllim që ata të plotësojnë formimin e tyre në frëngjisht, në matematikë dhe në gjermanisht;
- Në disa raste, mund të shtohen edhe dy periudha të tjera (p.sh. nxënësi ka hyrë në klasën e rakordimit 1 pasi ka ndjekur tri lëndë me nivel në nivelin 1 në vitin e 11-të).

Të gjitha lëndët vlerësohen, me përjashtim të qasjes ndaj botës profesionale. Vlerësimi i edukimit fizik është objekt i një njoftimi të posaçëm.

Kushtet e certifikimit

Për të marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë, **nxënësi i klasës së rakordimit 1** duhet të marrë shumën e pikëve vijuese për të dy grupet:

Grupi kryesor	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + anglisht + shkencat e natyrës + gjeografi - histori + arte vizuale - muzikë - veprimtari krijuese dhe punë dore	28 pikë e sipër
Grupi i kufizuar frëngjisht + matematikë+ gjermanisht		12 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta e shumta 1 pikë pamjaftueshmëri për grup.</i>		

Hyrja në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose të maturës profesionale

Nxënësi që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm në mbarim të klasës së rakordimit 1 mund të hyjë në shkollat e kulturës së përgjithshme të gjimnazeve apo të maturës profesionale sipas kushteve të caktuara në Rregulloren e gjimnazeve:

frëngjisht + matematikë+ gjermanisht	13,5 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në shumën e të gjitha këtyre pikëve.</i>	

Kontakti

Mme Corinne Morier-Genoud

Doyenne cantonale des classes de raccordement 1 (Dekane kantonale e klasave të rakordimit 1)
Établissement primaire et secondaire de Lausanne-Belvédère (Enti i shkallës së parë e të dytë
Lozanë-Belvedere)

Chemin des Croix-Rouges 24, 1007 Lausanne
corinne.morier-genoud@lausanne.ch - 021 315 61 53

Rac1 32 deri në 34 periudha	
Frëngjisht (niveli 2)	6 periudha
Gjermanisht (niveli 2)	4 periudha
Anglisht	4 periudha
Matematikë (niveli 2)	6 periudha
Shkencat e natyrës	2 periudha
Shkencat njerëzore e shoqërore ¹	2 periudha
Artet ²	2 periudha
Edukimi fizik	2 periudha
Përforcim niveli 2 frëngjisht - gjermanisht	3 (deri në 5) periudha
- matematikë	
Qasja ndaj botës profesionale	1 periudhë

Lëndët në tabelën e orarit

Mediat, figurat dhe teknologjitë e informimit dhe komunikimit (MITIC)

¹ Histori - Gjeografi - Qytetari

² Artet vizuale / Muzikë / Veprimtari krijuese dhe punë dore

Klasat e rakordimit 2

Paraqitje

Pas një viti shtesë në shkollimin e detyrueshëm, klasat e rakordimit 2 i mundësojnë nxënësit, që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm, marrjen e certifikatës së drejtimit paragjimnazial.

Nxënësi që ka marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit paragjimnazial ka qasje në të gjitha degët e formimit pas arsimit të detyrueshëm, nga gjimnazi deri në nxënien e një profesioni.

Kushtet e hyrjes në klasat e rakordimit 2

Nxënësi/ja i/e certifikuar në drejtimin e përgjithshëm mund të hyjë në klasën e rakordimit 2 nëse ai apo ajo ka ndjekur tri lëndët me nivel në nivelin 2 dhe nëse ai apo ajo i ka marrë të gjitha pikët vijuese për të dy grupet:

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + shkencat e natyrës	20 pikë e sipër ¹
Grupi II	anglisht + gjeografi - qytetari + histori - etikë e kulturë fetare	13,5 pikë e sipër

Rastet limite e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në njërin prej dy grupeve.

¹ Për nxënësin që ka ndjekur një zgjedhje të posaçme (OS) në zëvendësim të dy zgjedhjeve të aftësive të orientuara drejt profesioneve(OCOM), ky prag është me 24 pikë duke marrë parasysh mesataren vjetore të OS-ës.

² Për kalimin nga një klasë rakordimi 1 në një klasë rakordimi 2, lëndët përkatëse janë anglishtja dhe shkencat njerëzore e shoqërore dhe pragu është caktuar me 9 pikë e sipër.

Në raste të jashtëzakonshme dhe në bazë dosjeje, departamenti mund të bëjë përjashtim nga rregulli për kandidatët/et që nuk plotësojnë kushtet e hyrjes në klasën e rakordimit 2.

Kërkesat

Në fund të vitit të kryer në klasën e rakordimit 2, nxënësit duhet të kenë marrë të njëjtat njohuri dhe të njëjtat aftësi si nxënësit e vitit të 11-të të drejtimit paragjimnazial. Kjo kërkon jo vetëm mësimin e lëndëve të reja, por edhe një qasje të thelluar të lëndëve tashmë të studiuar, në përputhje me objektivat e përcaktuara nga Plani romand i studimeve (PER) dhe programet kantonale për ciklin 3. Nxënësi duhet të jetë i motivuar dhe i gatshëm të bëjë një punë të rëndësishme dhe kërkuese, edhe jashtë kohës shkollore.

Plani romand i studimeve (PER)

www.plandetudes.ch

PER-ja përcakton përmbajtjen e të nxënët në shkollimin e detyrueshëm për Zvicrën romande. Ai përshkruan atë që nxënësit duhet të mësojnë gjatë njëmbëdhjetë viteve të shkollimit.

Kërkesat për përjashtim nga rregulli për pranimin në klasën e rakordimit 2 duhet t'i drejtohen dekanit kantonale të këtyre klasave (shih të dhënat përballë). Ato duhet të përmbajnë një letër nga prindërit, ku të përshkruhet konteksti i kërkesës, të shoqëruar me formularin e regjistrimit, si dhe me një dosje të plotë. Për këtë qëllim, prindërit dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për të kuptuar rrugëtimin shkollor të nxënësit dhe nivelin e zotërimit të objektivave të planit të studimeve, në veçanti dokumentet zyrtare (dëftesat e fundit shkollore, certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë) të lëshuara nga institucioni në të cilin nxënësi/ja është shkolluar, si dhe çdo dokument tjetër të duhur.

Tabela e orarit

Klasat organizohen sipas modelit të drejtimit paragjimnazial. Tabela e orarit përmban nga 34 periudha në javë sipas ndarjes përballë.

Arsimi ofron katër zgjedhje të posaçme (OS) me nga tetë periudha javore: matematikë e fizikë, ekonomi e drejtësi, italisht ose latinisht. Në funksion të regjistrimeve, disa OS mund të propozohen vetëm në disa prej institucioneve shkollore, me qëllim që të mund të sigurohet një numër i mjaftueshëm nxënësish.

Për t'u regjistruar në një klasë rakordimi 2 me OS italishten, nxënësi duhet të ketë ndjekur me sukses kursin e lirë të italishtes në vitin e 11-të, ose të ketë ndjekur një OS të italishtes në shkallën e dytë, ose të provojë se ka njohuri të mjaftueshme në këtë gjuhë, të vlerësuara përmes provimit të njëvlershmërisë të organizuar nga departamenti në fillim të vitit shkollor.

Për t'u regjistruar në një klasë rakordimi 2 me OS latinishten, nxënësi duhet të ketë ndjekur OS-në e latinishtes në shkallën e dytë.

Lehtësime janë të mundshme për nxënësin që zgjedh një OS që tashmë e ka ndjekur edhe në shkallën e dytë.

Të gjitha lëndët vlerësohen. Vlerësimi i edukimit fizik është objekt i një njoftimi të posaçëm.

Kushtet e certifikimit

Aktualisht, për të marrë certifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë, **nxënësi i klasës së rakordimit 2** duhet të marrë të gjitha pikët vijuese për të dy grupet:

Grupi kryesor	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + anglisht + zgjedhje të posaçme (OS) + anglisht + shkencat e natyrës + gjeografi-histori + artet vizuale-muzikë	32 pikë e sipër
Grupi i kufizuar	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje të posaçme (OS)	16 pikë e sipër
<i>Rastet e veçanta</i>	<i>e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri për grup.</i>	

Kontakti

M. Alexandre Willemin

Doyen cantonal des classes de rattachement 2 (Dekan kantonal i klasave të rakordimit 2)
Établissement primaire et secondaire de Lausanne-L'Élysée (Enti i shkallës së parë e të dytë Lozanë-Elize)
Avenue de l'Élysée 6, 1006 Lausanne
alexandre.willemin@lausanne.ch
021 315 66 57

Rac2: 34 periudha	
Frëngjisht	5 periudha
Gjermanisht	4 periudha
Anglisht	4 periudha
Matematikë	5 periudha
Shkencat e natyrës	2 periudha
Shkencat njerëzore e shoqërore ¹	2 periudha
Artet ²	2 periudha
Edukimi fizik	2 periudha
Lëndë me zgjedhje të posaçme(OS) (latinisht me 4 periudha)	8 periudha


¹ Histori - Gjeografi - Qytetari

² Artet vizuale / Muzikë

Lëndët në tabelën e orarit

Mediat, figurat dhe teknologjitë e informimit dhe komunikimit (MITIC)

Struktura e shkallës së dytë I dhe hyrja në formimet pas arsimit të detyrueshëm Përmes klasave të rakordimit 1 dhe 2



¹ mundësi, me disa kushte, për të marrë sipas dëshirës një zgjedhje të posaçme

Më shumë informacione lidhur me formimet pas arsimit të detyrueshëm në www.vd.ch/dgcp.

Më shumë informacione lidhur me orientimin drejt profesioneve, degët e formimit dhe masat e tranzicionit në www.vd.ch/orientation.



www.vd.ch/scolarite

www.vd.ch/page/2020664

